



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0307
Data e Vendimit: 22.05.2026

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik Pricom SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me spaleta me numër të prokurimit 214/30400-26-1724-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Policia e Kosovës Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit Ardian Behra me 22.05.2026, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si e jashtafatshme, ankesa e Pricom SH.P.K., me Nr. të Protokollit 2026/0307, e datës 12.05.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me spaleta me numër të prokurimit 214/30400-26-1724-1-2-1, iniciuar nga Policia e Kosovës, në cilësinë e autoriteti kontraktues (AK).

II. I lejohet autoritetit kontraktues – Policia e Kosovës, që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit Furnizim me spaleta me numër të prokurimit 214/30400-26-1724-1-2-1, përkritazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

III. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 12.05.2026, ka pranuar ankesën me Nr. Protokollit 0307/2026 nga OE Pricom SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me spaleta me numër të prokurimit 214/30400-26-1724-1-2-1, iniciuar nga Policia

e Kosovës, në cilësinë e Autoriteti Kontraktues.

Me datën 08.04.2026 Autoriteti Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me spaleta me numër të prokurimit 214/30400-26-1724-1-2-1, ku afati i fundit për pranim të tenderëve ka qenë me datën 04.05.2026.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues me datën 30.04.2026 ka publikuar Formularin B54 – Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, përmes të cilit janë bërë ndryshime në afatet e procedurës. Sipas korrigjimit të fundit përmes Formularit B54, data përfundimtare për pranim të tenderëve është caktuar të jetë me datë 12.05.2026.

OE Pricom SH.P.K., Me datën 06.05.2026 në ora 19:12 e cila i bie të jetë me datën 07.05.2026 ka parashtruar kërkesë për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues e cila është refuzuar si e jashtë afatshme me datën 08.05.2026 në bazë të nenit 60.1. Operatori Ekonomik Pricom SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK - së me datën 06.05.2026 në ora 19:12 e cila i bie të jetë parashtruar me datën 07.05.2026 dhe e cila është në kundërshtim me RrPP-në Nenin 60 pikë 60.1 nënpika a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur RREGULLORE PËR PROKURIMIN PUBLIK – Versioni i konsoliduar 135 AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK është dita (0). Andaj mbështetur në Nenin 62 pikën 62.1 nënpika a) refuzohet si e jashtë afatshme kjo kërkesë për rishqyrtim. RrPP-në Nenin 62.1 Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur: a) Kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në nenin 60.1 të kësaj rregullore;

- Administrimi dhe Vlerësimi i provave -

OSHP sqaron se sipas nenit 60 pika 1 të Rregullores për Prokurimin Publik, Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksioni “kërkesat për rishqyrtim” brenda afateve të mëposhtme: a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore. Andaj nga provat e prezantuara dhe rrjedha e këtij aktiviteti të prokurimit konstatohet se kërkesa për rishqyrtim e parashtruar në Autoritetin Kontraktues është jashtë afatit ligjor, dhe jo ashtu siç është paraparë në nenin 60 paragrafi 1 pika a) të Rregullores për Prokurimin Publik pasi që kërkesa e parashtruar me datën 06.05.2026 në ora 19:12 e cila i bie të jetë parashtruar me datën 07.05.2026, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën e lartcekur

-Përfundim-

OSHP sqaron se OE Ankues ka qenë i obliguar që në pajtim me paragrafin 3.2 të nenit 108/A të LPP-së, brenda afateve ligjore të parashtroj kërkesë për rishqyrtim në AK dhe vetëm pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK, Operatori ekonomik në pajtim me nenin 109 të LPP-së do të mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Neni 108/A paragrafi 3.2 i LPP-së

përcakton se operatori ekonomik ankues kërkesën për shqyrtim duhet të dorëzoj tek autoriteti përkatës kontraktues: *në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose ose me dokumentet e tenderit*, se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Po ashtu, edhe neni 60.1 pika a) në Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik përcakton se: *Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur RREGULLORE PËR PROKURIMIN PUBLIK – Versioni i konsoliduar135AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.*

Përfundimisht nga shkresat e lëndës konstatohet se ankesa e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datë 12.05.2026, nga OE Pricom SH.P.K., për aktivitetin e prokurimit Furnizim me spaleta me numër të prokurimit 214/30400-26-1724-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues AK – Policia e Kosovës, hedhet si e jashtafatshme sepse ankuesi nuk ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim brenda afateve ligjore kundër njoftimit të Autoritetit Kontraktues. Andaj Organi Shqyrtues i Prokurimit në rrethana të tilla sqaron se vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake të rregullt dhe brenda afateve ligjore pranë AK, ankuesi mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. kjo ankesë është në kundërshtim me nenin, 108/A dhe 109 të Ligjit për Prokurim Publik, dhe nenit 60 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, dhe si e tillë hedhet si e jashtafatshme dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

OSHP gjithnjë niset nga rregullat, zgjidhjet dhe parimet e LPP sipas të cilit secili AK ushtron pavarësinë e tij/sajë në kuptim të nenit 8 dhe 9 lidhur me planifikimin e prokurimit dhe parashikimin e nevojave, mirëpo kriteret e parapara gjithnjë duhet ta garantojnë barazinë e OE të cilët parashihen si të tillë edhe me DT e cila në kuptim të nenit 27, lidhur me nenin 28, përbën dokumentin kyç të prokurimit publik. Andaj, Autoritetit kontraktues – Policia e Kosovës mund të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit (e përshkruar me sipër) nëse nuk ka ankesë tjetër për këtë aktivitet. Organi Shqyrtues i Prokurimit i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60, 65 të LPP-së.

Lidhur me tarifën ankimore vendoset në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, që operatorit ekonomik ankues ti kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Ardian Behra
Kryesues i Sekretariatit

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - POLICIA E KOSOVËS**
- **OE - " PRICOM " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: